

## **KLSH merr pjesë në takimin e organizuar nga shoqata “Together for Life”, për prezantimin e raportit të monitorimit të shpenzimeve në sektorin e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për vitin 2022**

Në datë 27 qershor 2023, në Hotel Tirana International, shoqata “Together for Life”, (e cila prej vitesh është e angazhuar për monitorimin e shpenzimeve në sektorin e shëndetësisë) organizoi një tryezë të rrumbullakët me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga Kuvendi i Shqipërisë, Ministrisë së Drejtësisë, disa institucioneve të pavarura, ekspertë dhe organizata të shoqërisë civile.

Në takim mori pjesë edhe një grup i Departamentit të Auditimit të Institucioneve Qendrore, i përbërë nga drejtori i Departamentit, z. Kozma Kondakçiu, audituesit Joniada Gocaj, Aldo Kume, Anjeza Goci dhe Erikliida Shpori.

Të pranishmit i përshëndeti Drejtoresha ekzekutive e TFL, znj. Eglantina Bardhi, e cila ndër të tjera vlerësoi ndihmesën e pjesëmarrësve e në mënyrë të veçantë punën e KLSH-së, që me raportet e saj është bërë një burim i besueshëm informacioni.

Nga gazetarja Auora Sulçe u prezantua raporti: “Monitorimi i shpenzimeve të sektorit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për vitin 2022”.



Në diskutimin e tij, z. Kozma Kondakçiu, duke vlerësuar raportin informoi të pranishmit se disa nga pyetjet e ngritura në këtë raport do të gjejnë përgjigje së shpejti me përfundimin e Auditimit në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, që është duke u zhvilluar nga Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore të KLSH-së.

